

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit S. N., nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson N. H., avokat nga ..., kundër të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A. Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F. S., nga Prishtina, për shkak të pagesës të diferencës së pagës, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.918/2014 datë 24.5.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 16.10.2018, merr këtë:

#### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.918/2014 datë 24.5.2018.

#### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.918/2014 datë 24.5.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 535/12 datë 24.9.2013 , me të cilin me pjesën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të ndryshimit të pagave nga grada 7 dhe 9 për periudhën prej 1.7.2005 e deri më 16.12.2013, t'i kompensojë diferencën e pagës dhe bonusit në shumën prej 11.451,16 €, si dhe kamatën e llogaritur prej ditës së ushtrimit të padisë 14.3.2012 deri më 30.6.2013 në shumën prej 503,15 €, në shumë të përgjithshme prej 11.954,31 €. Me pjesën II të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e veta.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të pranohet revizioni dhe aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar, ose ato të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, dhe gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura në kohë të pacaktuar në vendin e punës nëpunës kontabiliteti, në lokacionin Prishtinë, duke filluar nga data 1.7.2005, e tutje, për të cilin vend pune me kontratën nr..., datë ..., është paraparë paga sipas gradës 7. Komisioni i Ankesave i të paditurës me vendimin nr..., datë ..., ka aprovuar ankesën e paditësit duke kërkuar nga e paditura që për pozitën e nëpunësit të kontabilitetit të bëhet nivelizimi i gradave duke i vlerësuar të gjithë me të njëjtën gradë, pasi që Komisioni i Ankesave ka vlerësuar se nëpunësit e kontabilitetit pran të paditurës janë vlerësuar me grada të ndryshme (2 nëpunës të kontabilitetit janë vlerësuar me gradën 6; 2 nëpunës me gradën 7 dhe 1 nëpunës me gradën 9). Më datë ..., e paditura me paditësin kanë nënshkruar kontratën e punës nr..., në kohë të pacaktuar, për vendin e punës nëpunës i kontabilitetit për logjistikë për të cilin vend punë është paraparë grada 9.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësisoj, gjykata e shkallës së parë gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, sepse paditësi dhe e paditura raportet e tyre i kanë rregulluar me kontratë duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet reciproke në mes tyre, e cila kontratë me nenin 3 ka caktuar pagën bazë për punën të cilën e kryen paditësi dhe e njëjta është në harmoni me nenin 3 pika 1.11. të Ligjit të Punës, pastaj ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore në tërësi ka aprovuar qëndrimin juridik gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë dhe asaj të parë, lidhur me refuzimin si të pabazuar të kërkesëpadisë së paditësit pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave nuk janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Për më tepër gjykata e revizionit vlerëson se aktgjykimet e lartcekura nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës aktgjykimin e shqyrton konformë dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK –ës, vetëm në pjesën e tij të goditur me anë të revizionit dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, ndërsa në revizion nuk është cekur asnjë pretendim konkret se ku qëndrojnë shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, në cilën pjesë të aktgjykimit, apo në çka manifestohen ato.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi si të pabazuar pretendimin e cekur në revizion se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë me zbatimin e gabuar të drejtës materiale, ngase në revizion nuk është cekur asnjë pretendim konkret se cila dispozitë ligjore është zbatuar në mënyrë të gabuar. Ndërsa, kjo Gjykatë vlerëson si të drejtë qëndrimin e gjykatave të instancës më të ulët se në rastin konkret mungon baza juridike për pagesën e diferencës së pagës, ngase me kontratën e punës nr..., datë ..., është paraparë paga sipas gradës 7, të cilën e ka nënshkruar paditësi dhe është pajtuar me kushtet e kontratës. Konstatimi në aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët se kontrata e punës është në harmoni me nenin 11 të Ligjit të Punës, me të cilën parashihet përmbajtja e kontratës së punës, sipas kësaj Gjykate është i drejt dhe i bazuar në ligj, ndërsa neni 3 pika 1.11 e Ligjit të Punës, kontratën e punës e përcakton si akt individuale cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, kurse në rastin konkret me nenin 3 të kontratës së cekur janë përcaktuar kushtet e caktimit të gradës për punën të cilën do ta kryej paditësi, në të cilat i njëjti nuk ka pas vërejtje dhe kontratën e ka nënshkruar. Sipas kontratës nr..., të datës ..., paditësit i është caktuar paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 9. Me vendimin e Komisionit të Ankesave është kërkuar që të bëhet nivelizimi i gradave për gjithë nëpunësit e kontabilitetit të e paditura, ndërsa nuk ka qenë me ndikim që paditësit t'i paguhet diferenca e pagës sipas gradës së ndryshuar.

Për arsyet e paraqitura më lart , dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Rev.nr.320/2018 datë 16.10.2018

A

Kryetarja e kolegjit,  
Emine Kaçiku